



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË
MËSUESVE TË LËNDËS “KIMI”**

SHKURT, 2024

Koordinatore

Elisabeta Paja

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| I. HYRJE..... | 3 |
| II. QËLLIMI I PROGRAMIT | 3 |
| III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT..... | 4 |
| 3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit..... | 5 |
| 3.1.1 <i>Fushat kryesore të zhvillimit profesional</i> | 5 |
| 3.1.2 <i>Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe AML</i> | 11 |
| 3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit..... | 27 |
| 3.2.1 <i>Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML</i> | 27 |
| 3.2.2 <i>Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur</i> | 38 |

I. HYRJE

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësit, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit punojnë me përgjegjshmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, zhvillojnë dhe përditësojnë njohuritë nëpërmjet vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve të vazhdueshme, ndërtojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe bashkëpunojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së matematikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së kimisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit, si dhe për përgatitjen e orës së hapur mësimore për marrjen e kategorisë së parë të kualifikimit,
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen.

II. SYNIMET DHE QËLLIMET E PROGRAMIT

Synimet e hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi janë:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së kimisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar dhe të unifikuar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin, çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në dy pjesë:

3.1 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë (Mësues specialist) dhe të tretë (Mësues i kualifikuar) të kualifikimit. Në këtë rubrikë përfshihen, përveç kompetencave profesionale dhe rezultateve të pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, edhe dy modele testesh për lëndën e kimit në secilin nivel arsimor: arsim i mesëm i ulët (AMU) dhe arsim i mesëm i lartë (AML).*

3.2 *Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë* (Mësues mjeshtër) të kualifikimit. Në këtë rubrikë ka dy modele orësh mësimore për lëndën e kimisë në secilin nivel arsimor: *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.1 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të tretë të kualifikimit

Programi për mësuesit e kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë të kualifikimit përmban fushat kryesore të zhvillimit profesional, si dhe modele testesh për AMU dhe AML

3.1.1 Fushat kryesore të zhvillimit profesional

Ky program është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve të kategorisë së dytë dhe të kategorisë së tretë janë:

- dokumentacioni zyrtar¹ shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të kimisë;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së kimisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të kimisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

| FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR” | |
|--|---------------------------------|
| Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor” | Literatura e rekomanduar |

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

| | |
|--|---|
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollë; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. | <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020. • Udhëzimi nr.22 “Për fillimin e vitit shkollor 2022-2023 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (27.07 2022). • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021. • Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. • Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. • Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. • Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”. |
|--|---|

| FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË KIMISË” | |
|--|---|
| Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të kimisë në shkollë” | Literatura e rekomanduar |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare, 2014. • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e programit; • kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të kimisë); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacion që demonstroi lidhjen e matematikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale. | <ul style="list-style-type: none"> • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VIII-IX dhe klasa X -XII. |
|---|---|

| FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE” | |
|---|--|
| <p align="center">Kompetenca I</p> <p align="center">“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e Kimisë”</p> | <p align="center">Literatura e rekomanduar</p> |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i Kimisë:</i></p> | <ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së kimisë; • edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së kimisë; • motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. | <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së kimisë në arsimin e mesëm të ulët, 2018. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së kimisë në arsimin e mesëm të lartë, 2018. |
| <p>Kompetenca II</p> <p>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e kimisë”</p> | <p>Literatura e rekomanduar</p> |
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • për zgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdori metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikoi një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdori metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; | <ul style="list-style-type: none"> • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016. • Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së kimisë në arsimin e mesëm të ulët, 2018. |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • përdor termat shkencor në mësimdhënien – nxënien e kimisë; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • shpjegon parimet e hartimit të një testi për nxënësit. | <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së kimisë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018. • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020 Lënda: Kimi. • Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: Kimi . |
| Kompetenca III “Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në kimisë” | Literatura e rekomanduar |
| Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i kimisë:</i> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton materiale duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Poëer Point, Excel, Math Type në ëord; • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në kimisë duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; • gjen dhe përdor materiale nga Ëebsite për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së kimisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga ëebsite. | <ul style="list-style-type: none"> • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së kimisë që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie. • Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021. • Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021. |

| FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT” | |
|---|-------------------|
| Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit” | Literatura |

| | |
|--|--|
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. | <ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020. Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar” |
|--|--|

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

| <p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p style="text-align: center;">“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p> | <p style="text-align: center;">Literatura</p> |
|--|---|
| <p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> njuh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. | <ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. |

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

| <p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p style="text-align: center;">“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së kimisë”</p> | <p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p> |
|---|--|
| <p><i>Mësuesi i kimisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e kimisë në klasat VI-IX dhe X-XII; përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve shkencore në klasat VI-IX dhe X-XII; përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve; | <ul style="list-style-type: none"> Programe dhe tekste të lëndës së matematikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë. |

| | |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> dallon ndërvarësinë e koncepteve shkenore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; zgjdh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore të ushtrimeve të kimisë të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat VI-IX dhe X-XII; përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të kimisë në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme. | |
|--|--|

3.1.2 Modele të testeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

A. Model testi Kimi AMU

DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Bazuar në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, një nxënës që ndjek klasën e tetë të arsimit të mesëm të ulët, ka munguar 35% të orëve vjetore lëndore. Në një rast të tillë, nxënësi: **1 pikë**

- A) nuk klasifikohet në atë lëndë.
- B) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
- C) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.
- D) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.

2. Përcaktoni cili nga standardet e mëposhtme bën pjesë në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar: **1 pikë**

- A) Ideat dhe praktikat e qytetarisë.
- B) Bashkëpunimi me kolegët dhe komunikimi.
- C) Zhvillimi i njohurive dhe i aftësive të nxënësve rreth teksteve letrare dhe joletrare.
- D) Gjuha artistike dhe arti pamor.

3. Referuar Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, përmendni dy ndër detyrat e Këshillit të mësuesve të institucionit arsimor: **2 pikë**

a) _____

b) _____

PROGRAMI LËNDOR

4. Cili nga rezultatet e mëposhtme të të nxënës NUK bën pjesë në tematikën e diversitetit? **1 pikë**

- A) Nxënësi/ja shpjegon vetitë e të ngurtave, lëngjeve dhe gazeve.
- B) Nxënësi/ja shpjegon dallimin midis përbërjeve kimike dhe përzierjeve.
- C) Nxënësi/ja shpjegon dallimet mes metaleve dhe jometaleve.
- D) Nxënësi/ja shpjegon sjelljen e acideve dhe bazave.

5. Renditni tri kompetencat e fushës së shkencave natyrore, si komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor ku bazohet program i kimisë: **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

6. Lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera siguron një mësim të integruar. Shkruani dy nga fushat me të cilat lidhet fusha e shkencave natyrore. **2 pikë**

- a) _____
- b) _____

ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7. Të nxënës të lëndës së kimisë bëhet më cilësor kur mësuesit përshtatin një sërë rolësh: **1 pikë**

- A) të menaxherit, drejtuesit dhe kontrolluesit
- B) të ekspertit, demonstruesit dhe lehtësuesit
- C) të menaxherit, drejtuesit dhe vlerësuesit
- D) të menaxherit, drejtuesit dhe penalizuesit

8. Teknika gjatë së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive natyrore, proceseve etj. quhet: **1 pikë**

- A) Klaster
- B) Tabela e koncepteve
- C) Diagrami i “Venit”

D) Harta e koncepteve

9. Nëse hartoni një test kapitulli në lëndën e kimisë që ka 32 pikë, përcaktoni me sa pikë të fituara do ta vlerësoni nxënësin me notën: **2 pikë**

- a) 5 (pesë) _____
- b) 9 (nëntë) _____

10. Domenet e të mësuarit sipas taksonomisë së Bloom-it janë: **3 pikë**

- a) _____
- b) _____
- c) _____

11. Orët e suksesshme të mësimit janë ato që i nxisin nxënësit të mendojnë vetë dhe të përfshihen në të menduarit kritik. Tregoni tri nga përparësitë që ka aplikimi i metodave që nxisin të menduarit kritik në krahasim me metodat tradicionale të mësimit. **3 pikë**

12. Në kurrikulën bazuar në kompetenca, vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet vlerësimit të vazhduar, vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse, vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit. Plotësoni fjalët që mungojnë në pohimin e mëposhtëm: **3 pikë**

Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e procesit të _____ dhe motivon _____ e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe _____.

ASPEKTE TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS

13. Mësuesi/ja ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi/ja, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën? **1 pikë**

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

14. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për parimet themelore mbi të cilat hartohet Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar:

- a) Parimi i përkushtimit të prindërve ndaj nxënësit, mbi bazën e të cilit përcaktohen sjelljet që priten nga mësuesi në lidhje me procesin e të nxënës. V/G _____ **1 pikë**
- b) Parimi i përkushtimit ndaj komunitetit për krijimin e një mjedisi më motivues për arsimin. V/G _____ **1 pikë**

ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

15. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë? **1 pikë**

- A) klasat 9-ta të shkollës
B) klasat e 9 të shkollës
C) klasat e 9-ta të shkollës
D) klasat e 9-të të shkollës

16. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme. **3 pikë**

- a) elementet kimikë _____
b) kolonë makinash _____
c) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar _____

PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS


17. Procesi i ndarjes së një përzierjeje lëngjesh me pika vlimi të ndryshme kryhet me: **1 pikë**

- A) avullim
B) distilim
C) filtrim
D) sublimim

18. Gjysëmreaksioni që paraqet procesin e reduktimit është: **1 pikë**

- A) $Zn^{2+} + 2e^{-} \rightarrow Zn$
B) $Zn + 2e^{-} \rightarrow Zn^{2+}$
C) $Zn^{2+} \rightarrow Zn + 2e^{-}$
D) $Zn \rightarrow Zn^{2+} + 2e^{-}$

19. Cilët prej koeficientëve a, b, c dhe d janë koeficientet stekiometrikë të barazimit: **1 pikë**



- A) 2, 3, 1, 6

- B) 2, 3, 3, 1
- C) 3, 2, 1, 6
- D) 2, 3, 6, 1

20. Numri i protoneve, neutroneve, elektroneve tek joni i fosforit ${}_{15}^{31}\text{P}^{3-}$ është: **1 pikë**

- A) 15 protone, 16 neutrone, 16 elektrone
- B) 15 protone, 16 neutrone, 15 elektrone
- C) 15 protone, 16 neutrone, 18 elektrone
- D) 16 protone, 15 neutrone, 15 elektrone

21. Në cilin nga çiftet e mëposhtme përbërjet nuk janë izomere të njeri- tjetrit: **1 pikë**

- A) butanal dhe butanon
- B) butanol dhe butanal
- C) acidi butanoik dhe metanoat propili
- D) butanol dhe metil-2-propanol-1

22. Një nga përbërjet e mëposhtme është elektrolit i dobët. Ai është: **1 pikë**

- A) NaOH
- B) KCl
- C) CH_3COOH
- D) H_2SO_4

23. Gjatë elektrolizës së klorurit të kalciumit të shkrirë produkti që formohet në anodë është:

1 pikë

- A) Ca^{2+}
- B) 2Cl^-
- C) Cl_2
- D) Ca

24. Në elementin galvanik $\text{Fe} / \text{Fe}^{2+} // \text{Cu}^{2+} / \text{Cu}$. Gjenerimi i drejtë : **1 pikë**

- A) elektroda e bakrit sillet si anodë

- B) elektroda e bakrit e zvogëlon masën e saj
C) në elektrodën e bakrit ndodh oksidimi
D) elektronet lëvizin nga hekuri në drejtim të bakrit



1 pikë

Agjent oksidues është:

- A) H_2S
B) Br_2
C) H_2O
D) H_2SO_4

26. Vëllimi i hidrogjenit i matur në kushte normale që çlirohet nga veprimi i 4,6g natrium me ujin është: ($\text{Ar}_{\text{Na}} = 23$)

1 pikë

- A) 1,12 litra
B) 2,24 litra
C) 22,4 litra
D) 44,8 litra

27. Një mol i një përbërje organike ka këto karakteristika:

1 pikë

- Jep 2 mol CO_2 kur digjet
- Kur oksidohet jep acid karboksilik
- Nuk vepron me natrium (Na) metalik.

Përbërja është:

- A) $\text{C}_2\text{H}_5\text{OH}$
B) HCHO
C) CH_3CHO
D) CH_3OH

28. Në 0,25 mol sulfat amoni $(\text{NH}_4)_2\text{SO}_4$

2pikë




Njehsoni:

- a) numrin e molekulave
b) numrin e atomeve hidrogjen

($\text{Ar}_{\text{N}} = 14$, $\text{Ar}_{\text{O}} = 16$, $\text{Ar}_{\text{S}} = 32$, $\text{Ar}_{\text{H}} = 1$)

29. Përcaktoni tipin e reaksionit për reaksionet e mëposhtme:

3 pikë



30. Një tretësirë e ka pH = 2. Përcaktoni:

2 pikë

- a) përqendrimin e joneve hidrogjen,
b) përqendrimin e joneve hidroksil OH^- në tretësirë.

31. Barazimi termokimik i formimit të amoniakut është:



1 pikë



Njehsoni sasinë e nxehtësisë që çlirohet kur në reaksion marrin pjesë 4,48 litra azot.

32. Emërtoni sipas IUPAC-ut përbërjet e mëposhtme:

2 pikë



33. Në reaksionin redoks $Cu + HNO_3 \rightarrow Cu(NO_3)_2 + NO + H_2O$

Vendosni koeficientët duke ndërtuar skemën e këmbimit elektronik.

3 pikë

34. Sa mililitra ujë duhen shtuar në 200 ml tretësirë HCl me përqendrim 1,4 M për të përfutur një tretësirë me përqendrim 0,5 M.

2 pikë

35. Shkruani barazimet kimike për bashkëveprimet e mëposhtme: **3 pikë**
- a) fenol me NaOH
- b) propanon me KMnO_4 (me vlim)
- c) propanal me AgOH

36. Një përzierje zink me argjend me masë 50g tretet në sasi të mjaftueshme acidi klorhidrik dhe çlirohen 6,72 litra hidrogjen në (KN). Gjeni përqindjen e argjendit në përzierje. **3 pikë**
($\text{Ar}_{\text{Zn}} = 65$, $\text{Ar}_{\text{Ag}} = 108$)

Njihsoni vëllimin e etinit që përftohet nga bashkëveprimi i 120 g karbur kalciumi me pastërti 80% me ujin. ($\text{Ar}_{\text{Ca}} = 40$, $\text{Ar}_{\text{C}} = 12$, $\text{Ar}_{\text{H}} = 1$) **3 pikë**

37. Përcaktoni formulën e alkenit kur 0,1 mol H_2O adiconohen tek një alken dhe përftohen 6 gr alkool. ($\text{Ar}_{\text{H}} = 1$, $\text{Ar}_{\text{C}} = 12$, $\text{Ar}_{\text{O}} = 16$) **2 pikë**

38. Gjatë elektrolizës së tretësirës ujore të sulfatit të bakrit $\text{Cu}(\text{NO}_3)_2$ në anodë çlirohet 3,36 litra oksigjen. Cila substancë shkarkohet në katodë dhe në ç 'sasi? **3 pikë**
($\text{Ar}_{\text{Cu}} = 64$, $\text{Ar}_{\text{O}} = 16$)

B. Model testi kimi AML

KAPITULLI I DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR

1. Bazuar në "Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", një nxënës që ndjek klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë, ka munguar 30% të orëve vjetore lëndore. Në një rast të tillë, nxënësi: **1 pikë**

A) vlerësohet me shkrim nga një komision që ngre drejtoria e institucionit arsimor.

- B) vlerësohet me shkrim nga mësuesi i lëndës për njohuritë dhe konceptet, në të cilat ka munguar.
- C) nuk klasifikohet në atë lëndë.
- D) mbetet në klasë dhe përsërit vitin shkollor.
2. Bazuar në standardet e formimit të përgjithshëm të mësuesit në arsimin parauniversitar, një mësues analizoi të gjithë treguesit e standardit “Vlerësimi i të nxënësve”. Nga vetëvlerësimi i treguesve të këtij standardi, i rezultoi që mesatarja e pikëve për këtë standard ishte 3,6. Përcaktoni nivelin e arritjes së këtij standardi që korrespondon me këtë mesatare të pikëve:
- 1 pikë**
- A) Niveli 1
- B) Niveli 2
- C) Niveli 3
- D) Niveli 4
3. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) në lidhje me kriteret që duhet të plotësojë mësuesi që zgjidhet kryetar i ekipit lëndor:
- a) Të ketë punuar të paktën 10 vjet si mësues në po atë nivel arsimor. V/G _____ **1 pikë**
- b) Të jetë vlerësuar me të paktën “Shumë mirë” në provimin e kualifikimit, nëse e ka dhënë provimin. V/G _____ **1 pikë**

PROGRAMI LËNDOR

4. Cila prej karakteristikave të mëposhtme nuk i përket programit të kimisë, fusha shkencat e natyrës shkalla V:
- 1 pikë**
- A) Bazohet në qasjen bihevjoriste
- B) Konsideron të nxënësit si një proces aktiv
- C) Nxiti të nxënësve të integruar
- D) Vë theksin në zhvillimin e kompetencave
5. Renditni dy tematikat që përbëjnë programin e kimisë për shkallën 5. **2 pikë**
- a) _____
- b) _____
6. Thoni elementët që përbëjnë strukturën e programit të kimisë, fusha shkencat e natyrës, shkalla V. **3 pikë**

ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË

7. Diagrami i Venit bën pjesë në teknikat dhe metodat e: **1 pikë**
- A) zhvillimit të aftësive lexuese
 - B) zhvillimit të aftësive shkruese
 - C) zhvillimit të aftësive folëse
 - D) hulumtimit
8. Njëri nga aspektet e mëposhtme nuk bën pjesë në vlerësimin e punëve eksperimentale në lëndën e kimisë. Ai është: **1 pikë**
- A) Aftësitë që duam të vlerësojmë tek nxënësit.
 - B) Kohën e përshtatshme për të matur aftësitë.
 - C) Aftësitë praktike gjatë zhvillimit të eksperimentit.
 - D) Përdorimin e reagentëve në sasinë e caktuar.
9. Rezultati i të nxënit që bën pjesë në tematikën e ndërveprimeve është: **1 pikë**
- A) Përshkruan trysinë dhe temperature e një gazi sipas lëvizjes së grimcave të tij.
 - B) Përshkruan dhe shpjegon difuzionin.
 - C) Përshkruan si përqendrimi i një tretësire në mol/l është i lidhur me masën e substancës së tretur dhe vëllimin e tretësirës.
 - D) Përshkruan dhe shpjegon varësinë e shpejtësisë së difuzionit nga masa molekulare.
10. Lidh kërkesat në të dy kolonat sipas kuptimit që kanë midis tyre: **3 pikë**
- | | |
|--------------------------|---|
| 1. Kontrolli i njohurive | a) ka të bëjë me rezultatin e kontrollit |
| 2. Matja e njohurive | b) ka të bëjë me rezultatet e të mësuarit |
| 3. Vlerësimi i njohurive | c) nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi |
| | d) ka të bëjë me krahasimin e standardit mësues |
11. Nëse hartoni një test tremujori në lëndën e kimisë që ka 48 pikë, përcaktoni me sa pikë të fituara do ta vlerësoni nxënësin me notën: **2 pikë**
- 5 (pesë) _____ b) 9 (nëntë) _____

12. Plotësoni tri llojet e vlerësimit të përdorur në kimi referuar përshkrimin të dhënë më poshtë:

3 pikë

- a) _____ synon marrjen e informacionit nga mësuesi mbi atë që kanë arritur të përvetësojnë nxënësit bazuar në kompetencat kyçe dhe të fushës.
- b) _____ synon që të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve gjatë procesit të të nxënës.
- c) _____ synon identifikimin e njohurive dhe aftësive paraprake të nxënësve për të orientuar mësimin drejt plotësimit të nevojave të tyre për të nxënë.

13. Ilustroni me shembuj detyrat tematike, që do të përfshihen në portofolin e nxënësve tuaj përgjatë një tremujori për një klasë të caktuar.

2 pikë

ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

14. Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

1 pikë

- A) vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
- B) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
- C) vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
- D) përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

15. Zgjidhni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) për treguesit e parimit të përkushtimit ndaj komunitetit të përcaktuara në Kodin e etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar:

a) Mësuesi jeton në komunitet dhe për të. Ai ka në qendër të interesit të tij kthimin e shkollës, gjithnjë e më shumë, në qendër komunitare. V/G _____ **1 pikë**

b) Mësuesi pranon që trashëgimia gjuhësore dhe kulturore, familja dhe komuniteti nuk modelojnë marrëdhëniet e shkollës me komunitetin. V/G _____ **1 pikë**

ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

16. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

1 pikë

- A) viti 11-të i shkollës
- B) viti i 11 i shkollës
- C) viti i 11-t i shkollës
- D) viti i 11-të i shkollës

17. Përcaktoni nëse janë shkruar saktë (S) ose gabim (G), shprehjet e mëposhtme.

3 pikë

- a) livadhe të gjelbër____
- b) atlas gjeografik____
- c) Instituti i Shëndetit Publik____

PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

18. Lidhje hidrogjenore realizohet midis molekulave të substancës me formulë molekulare:

1 pikë

- A) O₂
- B) H₂Se
- C) HBr
- D) NH₃

19. Në molekulën e propinit atomet e karbonit janë:

1 pikë

- A) të gjitha të hibridizimit sp;
- B) të gjitha të hibridizimit sp²;
- C) të gjitha të hibridizimit sp³;
- D) një atom karboni i hibridizimit sp³dhe dy të hibridizimit sp;

20. Reaksioni i prapësueshëm $\text{CH}_4(\text{g}) + \text{H}_2\text{O}(\text{g}) \leftrightarrow \text{CO}(\text{g}) + 3\text{H}_2(\text{g})$ ndodhet në gjendje ekuilibri. Nëse rrisim [H₂] ekuilibri zhvendoset në drejtim të reaksionit, i cili çon në:

1 pikë

- A) rritjen e [CH₄]
- B) uljen e [CH₄]
- C) uljen e [H₂O]
- D) rritjen e [CO]

21. Përbërja që ka këndin valentor më të vogël është:

1 pikë

(Z_B=5; Z_C=6; Z_O=8; Z_P=15; Z_H=1; Z_{Cl}=17)

- A) PH₃
- B) BCl₃
- C) H₂O
- D) CH₄

22. Molekula, e cila nuk përmban atome të lidhura me forca të lidhjes kimike bashkërenditëse


është: ($Z_K=19, Z_S=16, Z_O=8, Z_C=6, Z_{Na}=11, Z_N=7, Z_{Cl}=17$)

1 pikë

- A) K_2SO_4
- B) K_2CO_3
- C) $NaNO_3$
- D) $NaClO_3$

23. Emri sistematik, sipas IUPAC, i përbërjes është:

1 pikë



- A) dihidroksi -1,2 amino-3,metil-4 pentanol;
- B) acidi hidroksi-1, amino-2, metil- 3 butanoik;
- C) acidi hidroksi-2, amino-3, metil- 4 pentanoik;
- D) acidi hidroksi-1,2 amino-3, metil- 4 pentanoik;

24. Numri atomik i elementit, elektroni i fundit i të cilit sipas radhës së mbushjes, ka këto vlera

të numrave kuantik: $n=4, l=1, m=-1, m_s=-1/2$, është:

1 pikë

- A) 32
- B) 34
- C) 36
- D) 38

25. Alkeni me masë molare 56 g/mol, sa lidhje sigma (σ) ka:

1 pikë



(Të dhëna: $A_{rC}=12, A_{rH}=1$)

- A) 10
- B) 11
- C) 12

D) 13

26. Jepen dy reaksione të elementit X, si më poshtë:

1 pikë



Çfarë është elementi X ?

- A) Halogjen
- B) Jometal
- C) Metal alkalini
- D) Metal amfoter

27. 6 litra SO_2 veprojnë me 4 litra O_2 për të formuar SO_3 , pas reaksionit:

1 pikë

I. përftohen 6 litra SO_3

II. 1 litër O_2 ka tepruar

III. 4 litër SO_2 është harxhuar

Cili nga pohimet e mësipërme është (janë) të sakta:

- A) vetëm I
- B) I dhe II
- C) II dhe III
- D) I dhe III



28. Përqendrimi normal i tretësirës 36,5 % HCl me dendësi 1,2 g/ml është :

1 pikë

(Të dhëna: $A_{\text{rCl}}=35,5$; $A_{\text{rH}}=1$)

- A) 1,2 N
- B) 2 N
- C) 10 N
- D) 12 N

29. Njehsoni ΔH për reaksionin e dhënë: $\frac{1}{2} \text{N}_2(\text{g}) + \text{O}_2(\text{g}) \rightarrow \text{NO}_2(\text{g})$ duke u nisur nga reaksionet:



1 pikë

30. Cilat janë produktet e elektrolizës së klorurit të bakrit CuCl_2 , me elektroda grafiti:

- a) në gjendje të shkrirë; b) në tretësirë ujore.

2 pikë

31. Për molekulën N_2O_3 ($Z_{\text{N}}=7$ dhe $Z_{\text{O}}=8$)

a) Paraqitni me anën e strukturave të Ljuisit formën gjeometrike

1 pikë

b) Përcaktoni nëse molekula është planare apo hapësinore?

1 pikë

32. Njehsoni gradën dhe konstanten e shpërbashkimit të acidit etanoik, në qoftë se në 15 gramë të këtij acidi gjenden në 0,5 litra tretësirë, ku përqendrimi i joneve hidron është 0,25M.

Të dhëna ($A_{\text{rC}}=12; A_{\text{rH}}=1; A_{\text{rO}}=16$)

2 pikë

33. Shkruani reaksionet e bashkëveprimit të:

a) Metil -2 butanol-2 + HCl

1 pikë

b) Dy molekula etanol

1 pikë

c) Butanon-2 + CH_3MgI

1 pikë

34. Digjet 0,1 mol i një alkeni, dendësia e të cilit është 3,125g/l. Dioksidi i karbonit i përfutur futet në tretësirë të hidrosidit të kalciumit. ($A_{rC}=12; A_{rCa}=40; A_{rO}=16; A_{rH}=1$)
- a) Njehsoni formulën molekulare të alkenit **1 pikë**
 - b) Njehsoni masën e karbonatit të kalciumit të precipituar **2 pikë**
 - c) Shkruani formulat e izomerëve të pozicionit që formon ky alken **1 pikë**

35. Njehsoni sa gramë tretësirë NaOH me përqendrim 10% duhen për asnjësimin e 200 gramë tretësirë H₂SO₄ me përqendrim 15%. (Të dhëna: $A_{rS}=32; A_{rNa}=23; A_{rO}=16; A_{rH}=1$)

3 pikë

36. Substancat A dhe B bashkëveprojnë sipas barazimit: $2A+B \leftrightarrow C$. Përqendrimi i substancës A është 6 mol/l, kurse i substancës B është 5 mol/l. Konstantja e shpejtësisë së reaksionit është $k=0,5$. Njehsoni shpejtësinë e reaksionit në momentin e parë dhe kur në përzierjen vepruese mbetet 30% e substancës B.

2 pikë

37. Një lidhje metalike bakër- zink (aliazh) me masë 25 gramë vepron me acidin klorhidrik. Përftohen 3,36 litra hidrogjen në kushte normale. Njehsoni përbërjen në përqindje të elementëve zink dhe bakër.

(Të dhëna $A_{rCu}=64; A_{rZn}=65$)

2 pikë

38. 24 gramë e një acidi monokarboksilik bashkëvepron me tepicë kalcium dhe formon 4,48 litra H₂ në kushte normale. Njehsoni formulën molekulare të acidit karboksilik.

(Të dhëna: $A_{rC}=12; A_{rO}=16; A_{rH}=1$)

3 pikë

39. Në tretësirën 0,1 M të Pb(NO₃)₂ me vëllim 200 ml u shtua tretësira 0,5 M e NaCl me vëllim 200 ml. Njehsoni nëse do të precipitohet PbCl₂ dhe nëse po, llogarisni sa do të jetë masa në gramë e tij.

($PT_{PbCl_2} = 1,6 \cdot 10^{-5}$); ($M_{PbCl_2} = 278$ g/mol)

3 pikë

40. Nga veprimi i 70 gramë fenol me natriumin metalik u përftua 5,6 litra hidrogjen të matura në kushte normale. Gjeni sa përqind e fenolit ka marrë pjesë në reaksion. ($A_{rC}=12$; $A_{rH}=1$; $A_{rO}=16$)

2 pikë

3.2 Përmbajtja e programit orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirëmenaduar dhe e mirëplanifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

3.2.1 Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Për të orientuar mësuesit që do të zhvillojnë orën mësimore të hapur për kategorinë e parë të kualifikimit, më poshtë është dhënë një model ore mësimore për secilin nivel arsimor: AMU dhe AML. *Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënësve, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.*

A. Planifikimi i orës mësimore të hapur

A.1. Mësuesi planifikon të gjithë **komponentët e orës së mësimimit** në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxënësve:

- planifikon rezultatet e të nxënit sipas programit lëndor;
- planifikon situatë të nxëni të cilën e përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies;
- planifikon organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit;
- planifikon pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.

A.2. Mësuesi planifikon temën mësimore me **qasje të reja inovative** që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore:

- planifikon *qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor;*
- planifikon *të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.*

B. Mjedisi i të nxënit

B.1. Mësuesi krijon një **klime pozitive dhe mjedis miqësor**, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe:

- *promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe;*
- *krijon një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.*

B.2. Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes:

- *organizon orën e mësimi duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me **detyra motivuese** dhe i nxit ata të ndër marrin iniciativa;*
- *nxit nxënësit të shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.*

C. Metodot mësimore

C.1. Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave dhe stileve të të nxënit:

- *përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënit;*
- *përdor metoda e teknika duke i dhënë mundësi nxënësit të përmirësojnë arritjet e tij.*

C.2. Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin):

- *përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit;*

- përdor metoda dhe teknika që nxisin diskutimin dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në veprimtari.

C.3. Mësuesi formulon pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme duke nxitur nxënësit të bëjnë pyetje përgjatë orës së mësimit:

- mësuesi ndërton pyetje sipas niveleve;
- nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit duke iu drejtuar dhe njëri – tjetrit.

D. Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve

D.1. Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij:

- përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit;
- përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit.

D.2. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes:

- përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore.

D.3. Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të nxënësve:

- angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënësit dhe nevojave të tyre.

E. Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale

E.1. Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore:

- krijon mjete mësimore didaktike në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore;
- nxit te nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.

E.2. Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve:

- përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut;
- përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.

**SHEMBUJ PLANIFIKIMI TË ORES MËSIMORE PËR ARSIMIN E MESËM TËË ULËT
DHE ARSIMIN E MESËM TË LARTË.**

- Orë mësimore në kimi AMU

| | | | |
|---|--------------------|--|--------------------|
| FUSHA: Shkencat e natyrës | LËNDA: Kimi | Shkalla: 4 | Klasa: VIII |
| TEMA MËSIMORE: Ngrohja dhe ftohja | | | |
| SITUATA E TË NXËNIT Qarkullimi i ujit në natyrë. | | | |
| REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE TË FUSHËS SIPAS TEMËS MËSIMORE: Nxënësi: | | FJALËT KYÇE | |
| <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan dukuritë (ndryshimet) kryesore të ndryshimit të lëngjeve dhe trupave të ngurtë gjatë ngritjes së temperaturës, pra gjatë ngrohjes. • Përshkruan dukuritë (ndryshimet) kryesore të ndryshimit të lëngjeve dhe trupave të ngurtë gjatë uljes së temperaturës, pra gjatë ftohjes. • Koncepton saktë dhe drejt termat “shkrirje”, “ngrirje”, “avullim”, “vlim”, “kondensim”, “sublimim”. • Argumenton si ngrohja dhe ftohja ndikojnë në jetën e planetit. | | <ul style="list-style-type: none"> Ngrohja Ftohja Shkrirja Ngrirja Avullimi Vlimi Kondensimi Sublimimi | |
| Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi; Shkencat shoqërore Fizika, Gjeografia, Art. | | Burimet Libri i nxënësit Skemë e qarkullimit në natyrë Video–projektor Media | |
| METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE <u>Veprimet në situatë:</u> | | | |

I) Imagjinatë e drejtuar / parashikim

Mësuesi/ja:

- Tregoj para nxënësve një material dhe kërkoj prej tyre që të mbajnë mend të gjitha ndryshimet fizike që ndodhin ose do të ndodhin.

Me anë të një video-projektori paraqes përpara nxënësve një video të shkurtër ku përshkruhen ndryshimet fizike që pëson uji në ciklin e qarkullimit të tij në natyrë . Ky prezantim i vendos nxënësit në imagjinatë dhe në situatë reale të të kuptuarit të proceseve që pëson uji. <https://youtu.be/jUnrhZGzZOë>

- Me anë të disa pyetjeve të cilat i referohen videos së paraqitur mësuesi i nxit nxënësit të ndërveprojnë dhe të shpjegojnë proceset që ndodhin në ciklin e qarkullimit e ujit.

Pyetje drejtuar nxënësve :

- Cilat veprime kanë lidhje me ndryshimet fizike të mësuara prej jush?
- Nxënësit veçojnë momentet në të cilat ata vunë re një veprim që çonte në ndryshim fizik.

Cilat ishin veprimet:

Avullimi(ngritje e temperaturës)

Kondensimi (ulja e temperaturës)

Trajtimi i situatës:

II) Ditar dypjesësh / ndërtimi i njohurive

Mësuesi/ja:

- organizon nxënësit në dyshe;
- secilës dyshe i jep materialin e përgatitur më parë;
- materiali do të japë informacion të plotë mbi ndryshimet fizike që ndodhin gjatë ngrohjes dhe ftohjes;
- disa grupe analizojnë ngrohjen dhe disa **diskutojnë si ngrohja dhe ftohja ndikojnë në jetën e planetit** (Informacioni i marrë nga burime të sigurta informacioni të faqeve zyrtare shkencore.)

Nr. 1

| Ngruhja | | |
|--|----------------------------------|-----------------------------------|
| Çfarë ndodh me grimcat e lëndës gjatë këtij procesi? | Si reagojnë substancat e ngurta? | Si reagojnë substancat e lëngëta? |
| | | |

Nr. 2

| Ftohja | | |
|--|----------------------------------|-----------------------------------|
| Çfarë ndodh me grimcat e lëndës gjatë këtij procesi? | Si reagojnë substancat e ngurta? | Si reagojnë substancat e lëngëta? |
| | | |

- kërkon nga secila dyshe plotësimin e fletës detyrës, duke shfrytëzuar të gjitha MJETET e informacionit.
- lihet në dispozicion të tyre koha e duhur duke vëzhguar me kujdes punën e gjithsecilit.

Përmbyllja e situatës:

III) Hartë koncepti / Përforcimi

Mësuesi/ja:

- diskuton me nxënësit për plotësimin e detyrës.
- komentet e tyre lexohen dhe interpretohen nga nxënës të ndryshëm; Më pas hidhen në tabelën e mëposhtme me ndihmën e mësuesit/es.
- forma përfundimtare e fletëve të punës do të jetë:
- **Nr. 1**

| Ngrohja | | |
|--|---|---|
| Çfarë ndodh me grimcat e lëndës gjatë këtij procesi? | Si reagojnë substancat e ngurta? | Si reagojnë substancat e lëngëta? |
| Temperatura ngrihet. Rritet energjia që zotërojnë grimcat. Rritet shpejtësia e lëvizjes së grimcave. Ndryshon gjendja e lëndës. | Grimcat të cilat nuk lëviznin, por vetëm lëkundeshin në gjendjen e ngurtë, me rritjen e temperaturës lëvizin lirshëm dhe rrëshqasin të pavarura. e ngurtë → e lëngët ↓ shkrirja | Grimcat të cilat lëviznin lirshëm në lëng me shpejtësi të madhe, shkëputen nga sipërfaqja e lëngut dhe kalojnë në gjendje të gaztë. tani lëvizja e tyre është kaotike e lëngët → e gaztë ↓ vlimi / avullim të lëngu |

Nr. 2

| Ftohja |
|--------|
| |

| Çfarë ndodh me grimcat e lëndës gjatë këtij procesi? | Si reagojnë substancat e ngurta? | Si reagojnë substancat e lëngëta? |
|---|--|--|
| -Temperatura ulet. -Ulet energjia që zotërojnë grimcat. -Ulet shpejtësia e lëvizjes së grimcave. -Ndryshon gjendja e lëndës. | Grimcat të cilat lëviznin në mënyrë të çrregullt e kaotike zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizjes së tyre deri sa do vijë një moment që do ta humbasin aftësinë për të lëvizur. e gaztë → të lëngët ↓ kondensimi | Grimcat të cilat lëviznin lirshëm në lëng, me uljen e mëtejshme të temperaturës humbasin aftësinë për të lëvizur kundrejt njëra tjetrës. e lëngët → të ngurtë ↓ Ngrirja |

Disa substanca të ngurta si jodi apo grafiti, me rritjen e temperaturës kalojnë direkt në gjendje të gaztë. Ky ndryshim i tillë fizik njihet me emrin sublimim.

Vlerësimi i situatës

Situata quhet e realizuar, kur nxënësit arrijnë të zgjedhin formën dhe gjuhën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë në lidhje me ngrohjen, ftohjen, të gjitha ndryshimet që pëson lënda dhe mënyrën e lëvizjes së grimcave.

Vlerësimi bazohet në mënyrën se si nxënësi:

- N2- Koncepton saktë dhe drejt termat “shkrirje”, “ngrirje”, “avullim”, “vlm”, “kondensim”, “sublimim”.
- N3- Përshkruan dukuritë (ndryshimet) kryesore të ndryshimit të lëngjeve dhe trupave të ngurtë gjatë ndryshimit të temperaturës, pra gjatë ngrohjes dhe të ftohjes. Diskuton më nxënësit lidhur me këto dukuri.
- N4- Analizon ngrohjen dhe argumenton **si ngrohja dhe ftohja ndikojnë në jetën e planetit**.

Detyrat dhe puna e pavarur: Në varësi të klasës dhe nivelit të nxënësve, mësuesi/ja vendos për pyetje dhe detyra në shtëpi:

- ✓ pyetje dhe detyra në fund të temës së mësimit, në fund të kapitullit ose tek fletorja e punës;
- ✓ pyetje dhe detyra të hartuara nga vetë mësuesi/ja.

• Orë mësimore në kimi AML

| | | | |
|---|--------------------|---|------------------|
| Fusha: Shkencat e natyrës | Lënda: KIMI | Shkalla: V | Klasa: XI |
| Tema mësimore: Alkanet | | Situata e të nxënit: Nxënësi me anë të shembujve nga jeta identifikon dhe njeh veçoritë e lëndëve djegëse. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - Përkufizon termat alkan, hidrokarbur, formulë empirike, molekulare, strukturore, seri homologe. - Përshkruan karakteristikat kryesore të alkaneve. - Përshkruan vetitë fizike të alkaneve dhe reaksionit e djegies të alkaneve. - Argumenton gatitjen e alkaneve. | | Fjalët kyçe : <ul style="list-style-type: none"> ➤ Hidrokarbure ➤ Alkane ➤ Formula empirike ➤ Formula molekulare ➤ Formula strukturore Seri homologe | |
| Mjetet: Teksti mësimor, video – Projektor, letra me ngjyra, lapustila | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë, Gjuhët dhe komunikimi, Gjeografia, Matematika | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <p>Mësuesi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantohet për nxënësit klasifikimin e hidrokarbureve dhe specifikoj hidrokarburet e pangopura. • Paraqes para nxënësve një dokumentar filmik që jep të dhëna për “alkanet”. <p>Kërkoj nga nxënësit që të shfrytëzojnë më së miri këtë burim informacioni.</p> <p>Veprimet në situatë: Alfabeti i njëpasnjëshëm</p> <p>Realizoj me nxënësit teknikën e “alfabetit të njëpasnjëshëm”. Për të realizuar këtë teknikë kam përgatitur për secilin nxënës një fletë pune që përmban shkronjat e alfabetit të vendosura në një tabelë. Secili nxënës shkruan në tabelën e alfabetit një term, një fjalë, një emër të cilat i dëgjuan në materialin filmik ose që ndoshta kanë pasur njohuri të mëparshme. Pasi e plotëson secili e këmben alfabetin me</p> | | | |

shokun ngjitur dhe ky veprim përsëritet disa herë zinxhir për 5 minuta. Në fund tabela ndoshta do të ketë një pamje të tillë.

| | | | | | |
|--------------------------|---------------|-------------|--|---|-------------------------------------|
| A Alkane aktivitet | B | D Djegje | E Emërtim Empirike Elektrone valentore | F Formulë empirike Formulë molekulare Formulë strukture | L Lëng Lidhje kovalente |
| M | R reaksion | Q | H Homologe Hidrogjen Hidrokarbur | S | K Jone negative Jone pozitive |
| O oksigjen | V Valenca | Z | T Karbon terciar | C Karbon | SH Shpërbërje |

veprimtari me lexim të drejtuar

Grupoj nxënësit në dyshe. Secilës dyshe i jap fletë punët e përgatitura më parë. Çdo fletë pune do ketë një pyetje të caktuar .U le pak kohë nxënësve të konkludojnë pyetjen dhe të gjejnë përgjigje të mundshme që lidhen me pyetjen e drejtuar.

Fleta Nr. 1

| Pyetja 1 | Komente të pritshme nga nxënësit |
|---------------------|--|
| Çfarë janë alkanet? | <ul style="list-style-type: none"> • Janë hidrokarbure • Kanë vetëm elementet C, H • Janë hidrokarbure të ngopura, kanë vetëm lidhje njëfishe. • Kanë formulë të përgjithshme molekulare C_nH_{2n+2} • Në emërtim marrin prapashtesën – an |

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> Një seri homologe përfaqëson një familje të komponimeve organike që kanë <ul style="list-style-type: none"> ✓ Formulë të përgjithshme të njëjtë ✓ Vetë të ngjashme kimike ✓ Kanë një rritje graduale të vetive fizike si p. sh. pikës së vlimit dhe pikës së shkrirjes. |
|--|---|

Fleta Nr. 2




| Pyetja | Komente të pritshme nga nxënësit | | | | | | |
|--|--|--|---------------------|----------------------|-----------------|-------------------------------|--|
| Me sa lloj formulash shprehet një përbërje organike? | <ul style="list-style-type: none"> Përbërjet organike mund ti shprehim me: Formulë empirike, shpreh raportin më të thjeshtë të atomeve në një molekulë p. sh. CH₄; Formulë molekulare, shpreh raportin real të atomeve në molekulë; Formulë strukturore, tregon mënyrën e vendosjes së atomeve në hapësirë. | | | | | | |
| | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Formula empirike</th> <th>Formula strukturore</th> <th>Formula e strukturës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>CH₃</td> <td>C₂H₆</td> <td> <pre> H H H - C - C - H H H </pre> </td> </tr> </tbody> </table> | Formula empirike | Formula strukturore | Formula e strukturës | CH ₃ | C ₂ H ₆ | <pre> H H H - C - C - H H H </pre> |
| Formula empirike | Formula strukturore | Formula e strukturës | | | | | |
| CH ₃ | C ₂ H ₆ | <pre> H H H - C - C - H H H </pre> | | | | | |

Fleta Nr. 3

| Pyetja | Komente të pritshme nga nxënësit |
|---|--|
| Cilat janë vetitë fizike dhe reaksioni i djegies së alkaneve? | <ul style="list-style-type: none"> Janë në gjendje të ndryshme agregate C₁ – C₄ - të gaztë C₅ - C₁₆ - të lëngët C₁₆ dhe më shumë atome C - të ngurtë; |

- Alkanet në gjendje të lëngët kanë erë karakteristike;
- Rritja e masës molare ndikon në rritjen e temperaturës së vlimit;
- Nuk treten në ujë sepse janë molekula polare;
- Treten në tretës organikë.

Reaksioni i djegies



Reaksioni i përgjithshëm i djegies

Propani dhe butani janë gaze që digjen duke dhënë flakë në temperatura të larta.

Përmbyllja e situatës: Rishikimi në dyshe

U jap nxënësve ushtrime

Ushtrimi 1: duke iu referuar formulës së përgjithshme të alkaneve listoni emrat dhe formulat molekulare të dhjetë përfaqësuesve të parë.

Ushtrimi 2: shkruani reaksionin e djegies së propanit dhe butanit. Ktheni këto reaksione në barazime kimike.

I lë nxënësit të punojnë për 5 minuta e më pas diskutojmë zgjidhjen e ushtrimeve.

Vlerësimi i situatës: Situata quhet e realizuar, kur nxënësit arrijnë të qartë veçoritë dhe karakteristikat e alkaneve. Vlerësoj nxënësit për aktivizimin dhe përgjigjet e sakta.

N2-Indetifikon emrat dhe formulat molekulare të dhjetë përfaqësuesve të parë të alkaneve.

N3-Zbaton vetitë kimike të alkaneve.

N4- Argumenton procesin e gatitjes së alkaneve me shëmbuj të ndryshëm.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësit që si kanë përfunduar ushtrimet i përfundojnë si detyrë shtëpie.
- Nxënësit duhet të sjellin shembuj të përdorimeve të alkaneve në jetën e përditshme dhe të përcaktojnë veçoritë e tyre.

3.2.2 Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

| Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur | | | | |
|---|---|---|---|--|
| Gjithsej 70 pikë | | | | |
| Përshkruesit | Niveli 1 - Dobët | Niveli 2 – Mjaftueshëm | Niveli 3 – Mirë | Niveli 4 – Shumë mirë |
| Planifikimi i orës mësimore të hapur (10 pikë) | | | | |
| Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të | 0 – 1 pikë Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënësit (RN) nuk | 2 – 3 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënësi, e | 4 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi, si dhe ka | 5 pikë Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënësit sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënësi të cilën e ka |

| | | | | |
|--|---|--|---|---|
| rezultateve të të nxënit | <i>bazohen në programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënit. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i> | <i>cila nuk ndikon shumë në përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënit, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i> | <i>planifikuar organizimin e nxënësve. Metodot dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënit dhe me stilet e të nxënit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i> | <i>përdorur si pjesë e metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i> |
| Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore | <i>0 – 1 pikë Mësuesi ka një planifikim ditor rutinë, pa u kujdesur për qasje të reja inovative dhe pa përfshirë edhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodot e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i> | <i>4 pikë Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodot e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i> | <i>5 pikë Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i> |
| Mjedisi i të nxënit (14 pikë) | | | | |
| Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, | <i>0 – 1 pikë Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimi vetëm disa</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni,</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë</i> |

| | | | | |
|---|---|--|---|--|
| respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe | <i>nxënës ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i> | <i>por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i> | <i>nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.</i> | <i>tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.</i> |
| Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes | <i>0 – 1 pikë Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësime dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasiv.. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i> |
| Metodat mësimore (21 pikë) | | | | |
| Mësuesi organizon nxënësit në varësi të metodave që do të përdorë dhe stilet të nxënësve | <i>0 – 1 pikë Mësuesi nuk organizon nxënësit në varësi të metodës së zgjedhur dhe demonstroi që nuk i njeh stilet e të nxënësve. Ora e mësimit është rutinë dhe kryesisht tradicionale.</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënësve të tij por ora e mësimit është tradicionale pa u kujdesur që nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre bazuar në stilin e tyre të të nxënësve.</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që i njeh stilet e të nxënësve të tij por metodat e teknikat që përdor në orën e mësimit nuk përfshijnë të gjitha stilet e të nxënësve duke krijuar kushte që jo të gjithë nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që njeh shumë mirë stilet e të nxënësve të tij dhe përdor metoda e teknika që i lidh më së miri me stilet e të nxënësve duke i dhënë mundësi nxënësve të përmirësojnë arritjet e tij.</i> |
| Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin) | <i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të</i> |

| | | | | |
|---|--|--|--|---|
| | <i>ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i> | <i>orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i> | <i>mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i> | <i>mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i> |
| Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit | <i>0 – 1 pikë Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje.</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i> |
| Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (17 pikë) | | | | |
| Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij | <i>0 – 1 pikë Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit.</i> | <i>2 – 3 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit.</i> | <i>4 - 5 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimit duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij.</i> | <i>6 - 7 pikë Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit Ai përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në</i> |

| | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | | <i>procesin e nxënies së nxënësit.</i> |
| Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes | 0 – 1 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi por nuk përdor nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënët të orës mësimore.</i> | 2 – 3 pikë <i>Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënët të orës mësimore.</i> | 4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi bazuar në nivelet e arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënët të orës mësimore.</i> | 5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënët të orës mësimore.</i> |
| Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënët dhe nevojave të nxënësve | 0 – 1 pikë <i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënët apo nevojat e nxënësve.</i> | 2 – 3 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i> | 4 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i> | 5 pikë <i>Mësuesi demonstroi se njeh nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënët dhe nevojave të tyre.</i> |
| Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (8 pikë) | | | | |
| Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore | 0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënët të temës mësimore.</i> | 2 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënët të temës mësimore.</i> | 3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënët të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i> | 4 pikë <i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënët të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre në mënyrë që të nxisë të nxënësit të mësuarin praktik dhe krijues.</i> |
| Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve | 0 – 1 pikë <i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënët të temës mësimore,</i> | 2 pikë <i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të</i> | 3 pikë <i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënët të temës mësimore, por nxënësit nuk</i> | 4 pikë <i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të</i> |

| | | | | |
|--|--|----------------------------------|--|--|
| | | <i>nxënit të temës mësimore.</i> | <i>angazhohen në përdorimin e TIK.</i> | <i>rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i> |
|--|--|----------------------------------|--|--|